

## Vendim nr. 211 datë 01.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 01.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (H) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

- KËRKUES:** **HAMID SHEHU, LEJLA CELCIMA (SHEHU), NAMIK SHEHU, SHQIPE ALLJASI (SHEHU), AVNI SHEHU, ISMET SHEHU, GJYLE TEP SHI (SHEHU), BUJAR SHEHU, ASIJE MANS AKU (SHEHU), ELIDA AGO (SHEHU), SADIJE SHEHU, SABRIE CEKANI (SHEHU), ARTI SHEHU DHE FLUTURA HOXHA,** përfaqësuar nga avokat Rasim Rama, me prokurë.
- OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2011-282) 145, datë 24.01.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2014-3019 (798), datë 10.11.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2023-3219, datë 14.06.2023 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
- BAZA LIGJORE:** **Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të një prej trashëgimlënësve të një subjekti të shpronësuar (*trashëgimlënësja*), i cili në bazë të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ka kërkuar njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin e një sipërfaqeje prej 140 dynmë “tokë pyll”, të ndodhur në fshatin Lalëz, Ishëm. Kërkesa është rrëzuar në rrugë administrative me arsyetimin se subjekti i shpronësuar nuk e provonte të drejtën e pronësisë së pretenduar.

2. Në vijim, trashëgimlënësja ka paraqitur padi, e cila është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. (11-2011-282) 145, datë 24.01.2011, me arsyetimin se dokumentacioni i paraqitur nga pala paditëse, edhe sikur nga pikëpamja formale dhe procedurale të ishte i rregullt, nuk provonte të drejtën e pronësisë të subjektit të shpronësuar. Sipas gjykatës, ishte e pamundur të identifikohesh vendndodhja e pasurisë dhe, pavarësisht kërkimeve të bëra në burimet arkivore, nuk u siguroi një hartë e vjetër për zonën Lalëz, Ishëm ku të përcaktoheshin njollat hartografike të pronësive dhe emrat e pronarëve.

3. Ndonëse trashëgimlënësja ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2014-3019 (798), datë 10.11.2014. Edhe sipas gjykatës së apelit, e cila ka përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor, vendndodhja e saktë e pronës nuk mund të përcaktohet as nga dokumentacioni i paraqitur dhe as nga ekspertimi i kryer nga një grup ekspertësh. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs trashëgimlënësja, e cila ka ndërruar jetë gjatë kohës që çështja pritej të merrej në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3219, datë 14.06.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

5. Në datën 19.07.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 02.08.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesve

6. *Kërkuesit*, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se prej vendimeve të kundërshtuara u janë cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

6.1.1. *E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm*, pasi gjykatat e zakonshme kanë shtrembëruar analizën e provave dhe fakteve, duke krijuar emërtime të ndryshme të vendndodhjes së pronave bazuar në harta të falsifikuara nga topografë të dënuar me vendime gjyqësore penale të formës së prerë. Gjykata e shkallës së parë nuk ka kryer shqyrtim gjyqësor të të gjitha kërkimeve të padisë, duke lënë pa përgjigje shfuqizimin e akteve për njohjen e së drejtës së pronësisë në favor të palës kundërshtare, prona e së cilës mbivendosej me pronën e tyre. Gjithashtu, ndonëse Gjykata e Lartë është gjendur përpara shkeljeve të rënda procedurale nga gjykatat e faktit, të parashikuara nga nenet 466 – 472 të KPC-së, nuk i ka marrë në konsideratë ato dhe nuk ka kryer as kalimin procedural tek trashëgimtarët e palës paditëse. Ndërsa gjyqtarët që kanë shqyrtuar çështjen në të dyja gjykatat e faktit janë përjashtuar nga sistemi si rezultat i procesit të vetingut.

6.1.2. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi padia është depozituar në datën 03.07.2008, ndërsa gjykimi ka përfunduar në Gjykatën e Lartë në datën 14.06.2023 me vendimmarrje mospranimi, në tejkalim të afateve ligjore të parashikuara nga dispozitat e KPC-së. Ky mohim i së drejtës për shkak edhe të vonesave i ka marrë edhe jetën trashëgimlënëse.

6.1.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se përse nuk e ka gjykuar çështjen në seancë gjyqësore dhe përse shkaqet e rekursit nuk qëndronin në kushtet kur të dyja gjykatat e faktit kanë kryer shkelje të ligjit procedural. Ndërsa vendimi i gjykatës së apelit ka kopjuar përmbajtjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

6.2. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi kanë humbur pronën për shkak se ekspertët e thirrur nga gjykata nuk arritën ta poziciononin në hartën treguese.

Prona e tyre është marrë padrejtësisht nga pala e paditur duke e regjistruar atë mbi

harta të falsifikuara. Mohimi i së drejtës së pronës është bërë për shkak të interesave të personave me pushtet.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkesesve

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se kërkuessit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi janë trashëgimtarë ligjorë të palës ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj justifikojnë interesin në çështjen e paraqitur.

9. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar.

10. Kolegji vëren se kërkuessit kanë pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi, sipas tyre, procesi gjyqësor nga momenti i regjistrimit të padisë e deri në dhënien e vendimit të Gjykatës së Lartë ka tejkaluar çdo afat ligjor. Ndërkohë nuk rezulton që ata të kenë paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, të parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Në këtë mënyrë, kërkuessit nuk kanë shfrytëzuar mjetet procedurale në dispozicion, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa për sa u takon pretendimeve të tjera që lidhen me cenimin e të drejtave për proces të rregullt ligjor (në aspektet e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor) dhe të pronës, kërkuessit i kanë shteruar në formë e substancë

mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, ndaj e kanë plotësuar kriterin për *shterimin e mjeteve juridike efektive*.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, kërkuesit pretendojnë se ankimi kushtetues individual i paraqitur në datën 19.07.2024 respekton afatin 4-mujor nga dita që atyre u është njoftuar vendimi nga sekretaria e Gjykatës së Lartë, duke paraqitur një kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë, në të cilin është vënë shënimi “*Vendimi u tërhoq sot më dt. 21.03.2024*”. Ndërsa vetë Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 16.10.2023.

13. Për sa më lart, Kolegji, bazuar në standardet kushtetuese, çmon se momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkuesve, nga i cili ka filluar afati ligjor 4-mujor, konsiderohet data 16.10.2023, kur vendimi i arsyetuar është bërë i disponueshëm për palët. Vetëm paraqitja e vendimit gjyqësor me shënimin për datën se kur është tërhequr vendimi nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht të kërkuesve, pasi një shënim i tillë mund të vendoset në çdo kohë dhe me kërkesë të kujtdo që paraqitet në Gjykatën e Lartë. Në këto rrethana, ankimi është paraqitur prej kërkuesve në datën 19.07.2024, pra pas 9 muajve nga dita që vendimi ishte i bërë i disponueshëm për ta. Për rrjedhojë, kërkuesit nuk legjitimohen *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Për më tepër, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesve nuk përmbushin as kriterin *ratione materiae*, pasi në analizë të thelbit të argumenteve të tyre ato lidhen me vlerësimin e provave dhe fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, të cilat sipas jurisprudencës së konsoliduar kushtetuese ato janë në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se kërkuesit kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, të cilat nuk kanë tejkalluar funksionet kushtetuese dhe as nuk kanë interpretuar ligjin në mënyrë arbitrare.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “ç”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.